

## VIZE PER FAMILJARE TE NENSHTETASIT TE BE-së

Viza për qëndrim të persona me vendbanim në Itali që janë nënshtetas italianë ose të Bashkimit Europian, i lejon hyrjen në Itali atij personi i cili, në bazë të Dekretit Legjislativ n. 30/2007, rezulton të jetë Familiar i një nënshtetasi të Bashkimit Europian me vendbanim të rregullt në Itali. Më saktësisht, këtë të drejtë e gëzojnë kategoritë e mëposhtëme:

- bashkëshorti/bashkëshortja;
- partneri/partnerja e cili/e cila ka celebruar me nënshtetasin e BE-së një lidhje martesore të regjistruar në njërin prej Shteteve anëtare;
- pasardhësit e drejtpërdrejtë ose të bashkëshortit/bashkëshortes ose partnerit/partneres, nën moshën 21 vjeç, ose persona në ngarkim të tyre;
- para-ardhësit e drejtpërdrejtë ose të bashkëshortit/bashkëshortes ose partnerit/partneres, në ngarkim të tyre;

*Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për qëndrim të persona me vendbanim në Itali që janë nënshtetas italianë ose të Bashkimit Europian duhet të paraqitet personalisht pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me gërma të mëdha shtypi. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkangjiten dokumentet e poshtëshënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:*

**1) Pasaportë të vlefshme** të paktën 3 muaj nga data e fillimit të afatit të vizës së kërkuar;

**2) Letra e Ftesës** e nënshkruar nga nënshtetasi i BE-së, në të cilën të kërkohej prania, në Itali, e familjarit në vendin e origjinës dhe të vërtetohet plotësimi i kushteve ligjore përkatëse;

**3) Fotokopje e qartë e letërnjoftimit të nënshtetasis të BE-së;**

**4) Kopje e Certifikatës së vendbanimit**, të lëshuar nga komuna e vendbanimit të nënshtetasis të BE-së, në datë jo më të hershme se 6 muaj;

**5) Dokumente të Gjendjes Civile** që vërtetojnë lidhjen familjare me personin me banim në Itali:

-nëse vizita bëhet të bashkëshorti/tja me banim në Itali:

**çertifikata e martesës**, e lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

-nëse vizita bëhet të babai/nëna me banim në Itali:

**çertifikata/t e lindjes e/së fëmijës/ve**, e/të lëshuar/a nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e/të legalizuar/a nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

-nëse vizita bëhet të djali/vajza me banim në Itali:

**çertifikata e lindjes e djalit/vajzës** me banim në Itali, të lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

**6) Deklarata mbi Bashkësinë Familjare**, që dëshmon mbajtjen e anëtarëve të familjes, i lëshuar nga Komuna përkatëse në datë jo më të hershme se 6 muaj, dhe e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile në Prishtinë;

**KUJDES:** në këtë dokument duhet pasqyruar **gjendja familjare reale** e të interesuarit pavarësisht nga fakti nëse në të janë të pranishëm edhe familjarë të tjerë që nuk duhet të udhëtojnë për në Itali.

**\*\*\*Në rast vizite te babai/nëna me vendbanim në Itali** të të miturve që udhëtojnë vetëm, përveç dokumenteve të lartshënuar, do të kërkohet **Pëlqimi mbi daljen e përhershme të të miturit për Bashkim Familjar**. Pëlqimi jepet përpara zyrtarit përgjegjës për viza pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë nga prindi që mbetet në Kosovë dhe që nuk është i pajisur me vizë ose Leje qëndrimi të vlefshme në Itali ose pranë një noteri.

**\*\*\*Në rast vizite te djali ose vajza me vendbanim në Itali, nënshtetas të BE-së,** përveç dokumenteve të lartshënuar duhet të paraqiten edhe dokumentet e mëposhtëme:

**Vërtetim mbi pensionet** (nëse aplikuesi është në pension)/ **Kontratë e punës** (nëse aplikuesi është në raport pune)/ **Vërtetim mbi papunësinë** (nëse aplikuesi nuk e ka mbushur moshën për pension dhe nuk është në marrëdhënie pune); **çertifikatë vendbanimi** e djemve dhe vajzave në Kosovë, e lëshuar nga komuna kompetente si edhe **kopjet e Lejeve të Qëndrimit** në shtete të tjera (nëse fëmijët jetojnë jashtë Kosovës).

AMBASADA ITALIANE PRISHTINE